REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"**
**FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK**
**DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR**

# Kodi i lëndës: INF 275
# Lënda: Traumatologji dhe Kujdes Paliativ

| PROGRAMI I LËNDËS<br>**Traumatologji dhe Kujdes Paliativ** | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Titullari i lëndës:** | **Petraq Mustaqe** *Doktor Shkencash*___________________ | | | | | | | | |
| **Ngarkesa:** | Kredite | Orë mësimi në auditor | | | | | | Studim individual | Totali |
| | | Leksion | Seminar | Labs | Praktikë | Projekte | Total | | |
| | 6 ECTS | 45 | 0 | 0 | 30 | 0 | 75 | 75 | 150 |
| **Tipologjia e lëndës** | Lëndë ndërdisiplinore / integruese | | | | | | | | |
| **Vitiakademik /Semestri kur zhvillohet lënda** | Viti II, Semestri II | | | | | | | | |
| **Lloji i lëndës** | Me zgjedhje | | | | | | | | |
| **Programi i studimit** | Bachelor në Infermieri Mami | | | | | | | | |
| **Kodi i lëndës** | INF 275 | | | | | | | | |
| **Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës** | petraq.mustaqe@univlora.edu.al | | | | | | | | |

| **PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT** | |
|---|---|
| **Përshkrimi i lëndës** | Traumatologjia është një lëndë që zhvillohet në vitin e dytë. Në programin e saj jemi përpjekur të japim konceptet e përgjithshme për të gjitha traumat dhe politraumat në mënyrë që një infermier të ketë bagazhin e nevojshëm për tu punësuar në qëndër politraume.<br>Në lëndën e "Kujdesit Paliativ", studentët do të pregatiten përkujdesin infermieror në pacientët me sëmundje kronike, onkologjike si dhe lehtësimin e dhimbjes dhe përmirësimin e simptomave në këta pacientë. |
| **Objektivat e lëndës** | Në përfundim të këtij kursi studentët do të kenë njohuri në drejtim të<br>▪ Njohjen me faktorët riskantë të shëndetit të pacientit me trauma.<br>▪ Paraqitjen e vlerësimit klinik të personit të aksidentuar.<br>▪ Njohja me dëmtimet sipas trakteve dhe sistemeve, si dhe me strategjitë e menaxhimit të tyre.<br>▪ Paraqitja e vlerësimit klinik, etika dhe menyra e komunikimit me personin në fundin e jetës. |
| **Rezultatet e pritshme** | Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje:<br>☞ Të diagnostikojnë patologjitë kryesore të periudhës nga momenti i aksidentit deri ne trajtimin spitalor.<br>☞ Të diagnostikojnë klinikisht patologjitë kryesore traumatike.<br>☞ Të kenë njohuri për strategjitë moderne të menaxhimit të traumave.<br>☞ Të prezantojë raste klinike tërësore: nga etiologjia tek plani i asistencës.<br>☞ Të kuptojë rolin e profesionistit të shëndetit në ofrimin e kujdesit paliativ cilësor.<br>☞ Të diskutojnë dhe interpretojnë aspektet e vlerësimit psikologjik, shpirtëror dhe social të cilësisë së jetës. |

## KONCEPTET THEMELORE

1. Traumatsipassistemeve
2. Frakturat
3. Kujdespaliativ
4. Fundi i jetes

| Java | TEMAT E LËNDËS | Literatura referuese | Forma e mësimdhënies |
|---|---|---|---|
| I. | **Tema 1 -** Traumat sipas sistemeve. Triazhimi<br>*Triazhimi dhe vleresimi primar i gjendjes shendetesore te pacientit*<br>**Tema 2 -**Demtimet me te shpeshta ne traumatologji.<br>*Hemoragjia, Aresti etj.*<br>**Tema 3 -** Politrauma.Traumat torakale<br>*Kujdesi infermieror dhe njohja me demtimet torakale.*<br><br>**Praktikë mësimore -** Praktikë mësimore në pavionin e Kirurgji-Ortopedisë/ Urgjence. Përvetësimi i njohurive kryesore mbi demtimet me te shpeshta dhe menyra e vleresimit primar te pacientit te traumatizuar | *fq. 7-23*<br><br>*fq. 24-32*<br><br><br>*fq. 32-44* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br>*Praktikë 2 orë* |
| II. | **Tema 4 -**Traumat torakale.<br>*Urgjenca madhore me komplikim te ap. Respirator kombinuar me demtime dhe kufizime*<br>**Tema 5-** Traumat kardio-vaskulare.<br>*Demtimi traumatik i murit torakal dhe organit pompe, perben rrezikun me te madh per jeten e pacientit te demtuar*<br>**Tema 6 -** Komplikacionet akute post-traumatike pulmonare, edema pulmonare.<br>*Edema akute pulmonare është një prej gjendjeve me kritike të shumë efekteve klinike të dështimit teë zemrës.*<br><br>**Praktikë mësimore -** Praktikë mësimore në pavionin e Kirurgji-Ortopedisë/ Urgjence. Përvetësimi i njohurive kryesore mbi dëmtimet më të shpeshta torakale dhe mënyra e vlerësimit të pacientit të traumatizuar. | *fq. 44-60*<br><br><br>*fq. 61-75*<br><br>*fq.289-312* | Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br>*Praktikë 2 orë* |
| III. | **Tema 7 -** Traumat e syrit, veshit dhe rrrugëve të sipërme respiratore.<br>*Dëmtimet më të shpeshta të syrit, veshi, dhe rrugëve të sipërme respiratore.*<br>**Tema 8 – 9 -**Traumat abdominale, traumat e heparit dhe lienit.<br>*Njohja me demtimet traumatike te organeve parenkimatoze*<br><br>**Praktikë mësimore -** Praktikë mësimore në pavionin e Kirurgjisë. Përvetësimi i njohurive kryesore mbi demtimet me te shpeshta te organeve parenkimatoze | *fq. 94-113*<br><br>*fq. 76-83* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 2 orë<br><br><br>Praktikë 2 orë |
| IV. | **Tema 10 -** Traumat e anësive të sipërme.<br>*Traumat e rrethit të supit dhe luksacioni akromio-klavikular dhe sternoklavikular. Frakturat e skapulës dhe luksacioni traumatik skapulo-humeral.*<br>**Tema 11 –** Traumat e anësive të sipërme<br>*Frakturat e humerusit, frakturat e artikulacio kubiti dhe frakturat e kockave të parakrahut.*<br>**Tema 12 -** Frakturat, luksacionet dhe frakture-luksacionet e kolonës vertebrale.<br>*Fraktura është ndërprerje e plotë ose e pjesshme e vazhdimësisë së kockës. Ndodh atëherë kur kocka është subjekti një force apo traume të jashtme.* | *fq. 138-146*<br><br><br>*fq. 146-149*<br><br><br>*fq. 176-182* | Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë |

| Java | TEMAT E LËNDËS | Literatura referuese | Forma e mësimdhënies |
|---|---|---|---|
| | **Praktikë mësimore -** Praktikë mësimore në pavionin e Kirurgjisë Përvetësimi i njohurive kryesore mbi demtimet me te shpeshta te kockavedhe shtylles kurrizore | | *Praktikë 2 orë* |
| **V.** | **Tema 13 -** Frakturat e bacinit.<br>*Menaxhimi infermieror në traumat e bacinit.*<br>**Tema 14 -** Traumat urologjike dhe genitale.<br>*Individët përjetojnë dhimbje dhe prishje te funxionit në rajonin e demtuar.*<br>**Tema 15 -** Traumat e sistemit nervor.<br>*Kur sistemi ndijor dëmtohet nga trauma, rrjeti nervor që i përket atij sistemi nuk mund të funksionojë normalisht për të transmetuar siç duhet ndjesinë në zonat e trurit. Kjo shpesh çon në të mungesë të ndjesisë, individët përjetojnë dhimbje në rajonin e prekur.*<br><br>**Praktikë mësimore -** Praktikë mësimore në pavionin e Kirurgjisë Përvetësimi i njohurive kryesore mbi dëmtimet më të shpeshta të kockave dhe trajtimi i dëmtimeve uro-genitale. | *fq. 131-160*<br><br>*fq. 84-93*<br><br>*fq. 176-182* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br><br><br>*Praktikë 2 orë* |
| **VI.** | **Tema 16 -** Traumat e kokës.<br>*Një goditje **e** lehtë në kokë mund të jetë fatale, ndaj ajo nuk duhet neglizhuar. Dëmtimet **e** trurit shpesh janë të pakthyeshme.*<br>**Tema 17 -** Traumat e anesive të poshtme.<br>*Dëmtimet e artikulacionit të gjurit*<br>**Tema 18 –** Traumat e anësive të poshtme<br>*Frakturat e tibies dhe fibulës.*<br><br>**Praktikë mësimore -** Praktikë mësimore në pavionin e Kirurgjisë dhe Ortopedise. Përvetësimi i njohurive kryesore praktike mbi demtimet më të shpeshta të kockave dhe trajtimi i dëmtimeve. | *fq. 183-194*<br><br><br>*fq. 149-160*<br><br>*fq. 149-160* | Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>*Praktikë 2 orë* |
| **VII.** | **Tema 19 – 20 -** Traumat e anësive të poshtme.<br>*Frakturat e femurit (proksimale, të diafizës, distale), luksacioni traumatik koksofemoral. Dëmtimet e artikulacionit talokrural.*<br>**Tema 21 -** Parimet e amputacioneve dhe protezimeve.<br>*Amputacioni dhe protezat.*<br><br>**Praktikë mësimore -** Praktikë mësimore në pavionin e Kirurgjisë dhe Ortopedise. Përvetësimi i njohurive kryesore praktike mbi dëmtimet më të shpeshta të kockave dhe trajtimi i dëmtimeve | *fq. 149-160*<br><br><br>*fq. -152-163* | Leksion 2 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>*Praktikë 2 orë* |
| **VIII.** | **Tema 22 -** Traumat pediatrike.<br>*Vlerësimi i Traumes pediatrike nuk duhet të jetë mjeti i vetëm i përdorur për të diagnostikuar lëndimet cerebrale traumatike të lehta te fëmijët e moshës 6-18 vjeç, por diagnoza duhet të përfshijë përdorimin e një shkalle vlerësimi të simptomave, në bazë të moshës.*<br>**Tema 23 -** Alkoli dhe drogat. Menaxhimi i komplikacioneve të pacientit të traumatizuar<br>*Dëmtimet* fizike/*traumat, mund te ndodhin shpesh prej* çrregullimeve psikike te të varësuarit *nga alkooli* ose/*dhe drogat* ilegale.<br>**Tema 24 -** Rehabilitimi i pacientit traumatik.<br>*Parimet e reabilitimit të pacientit traumatik. Kujdesi infermieror gjatë kësaj periudhe.* | *fq. 114-129*<br><br><br><br>*fq. 230 - 235*<br><br><br>*fq. 200-219* | Leksion 1 orë<br><br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë |

| Java | TEMAT E LËNDËS | Literatura referuese | Forma e mësimdhënies |
|---|---|---|---|
| | **Praktikë mësimore -** Praktikë mësimore në pavionin e Kirurgjisë dhe Ortopedise. Përvetësimi i njohurive kryesore praktike mbi dëmtimet më të shpeshta të kockave dhe trajtimi i dëmtimeve | | *Praktikë 2 orë* |
| IX. | **Tema 25 –** Monitorizimi invaziv dhe jo-invaziv tek pacientët traumatik.<br>*Crush-sindrome dhe IRA*<br>**Tema 26 -** Njohuri të përrgjithshme mbi kujdesin paliativ.<br>*Kujdesi Paliativ trajton jo vetëm çështjen e vuajtjes fizike nga sëmundja, por edhe çështje që lidhen me të drejtën njerëzore për të patur një fund sa mëte qete.*<br>**Tema 27 -**Përkufizimi dhe koncepti i dhimbjes dhe i "dhimbjes në tërësi", anatomia, fizpatologjia.<br>*Dhimbja është një eksperiencë e pakëndshme sensore dhe emocionale e lidhur me një dëmtim indor aktual ose potencial ose e përshkruar si e tillë*<br><br>**Praktikë mësimore -** Praktikë mësimore në pavionin e Kirurgjisë dhe Ortopedise. Përvetësimi i njohurive kryesore praktike mbi dëmtimet më të shpeshta të kockave dhe trajtimi i dëmtimeve | *fq. 267-278*<br><br>*fq. 1 - 4*<br><br><br>*fq.5 - 10* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br>*Praktikë 2 orë* |
| X. | **Tema 28 -**Principet bazë në trajtimin dhe menaxhimin e dhimbjes.<br>*Eksperiencë e pakëndshme sensore dhe emocionale. Ndryshe nga ndjesitë e tjera si shikimi, dëgjimi, nuhatja, shija dhe prekja, dhimbja është gjithnjë e lidhur me një emocion të pakëndshëm*<br>**Tema 29 -** Principet bazë në trajtimin dhe menaxhimin e dhimbjes.<br>*Eksperiencë e pakëndshme sensore dhe emocionale. Ndryshe nga ndjesitë e tjera si shikimi, dëgjimi, nuhatja, shija dhe prekja, dhimbja është gjithnjë e lidhur me një emocion të pakëndshëm*<br>**Tema 30 -** Principet bazë në menaxhimin e simptomave.<br>*Simptomat kryesore dhe menaxhimi i tyre.*<br><br>**Praktikë mësimore -** Praktikë mësimore në pavionin e Kirurgjisë dhe Ortopedise. Përvetësimi i njohurive kryesore praktike mbi dëmtimet më të shpeshta të kockave dhe trajtimi i dëmtimeve | *fq. 11 – 15*<br><br><br><br>*fq. 16 – 18*<br><br><br><br>*fq. 19 - 22* | Leksion 1 orë<br><br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>Praktikë 2 orë |
| XI. | **Tema 31 -** Principet bazë në menaxhimin e simptomave.<br>*Simptomat kryesore dhe menaxhimi i tyre.*<br>**Tema 32 -** Aspektet psikologjike dhe shpirtërore në kujdesin paliativ.<br>*Kujdesi paliativ përfshin aspektet psikologjike dhe shpirtërore* të *kujdesit* për pacientin.<br>**Tema 33 -** Identifikimi i nevojave dhe problemeve të pacientëve.<br>*Pacientet kanë të drejtë për kujdesje për shëndetin e tyre; ta përfitojnë atë sipas nevojave, si në raste akute ashtu dhe kronike*<br><br>**Praktikë mësimore -** Në pavionin e Reanimacionit, Kujdesit paliativ dhe Kimio-Terapisë. | *fq. 23 – 26*<br><br>*fq. 27 – 33*<br><br><br>*fq. 34 – 40* | Leksion 1 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br>*Praktikë 2 orë* |
| XII. | **Tema 34 – 35 -** Kujdesi paliativ në sëmundjet kronike.<br>*Kujdesi paliativ është koncepti bazë i kujdesit, i cili ofrohet per pacientët në fazat e fundit të sëmundjeve kronike, sëmundje obstruktive etj.*<br>**Tema 36 -** Kujdesi paliativ ne semundjet onkologjike.<br>*Kujdesi paliativ është koncepti bazë i kujdesit, i cili ofrohet per pacientët në fazat e* | | Leksion 2 orë<br><br><br>Leksion 1 orë |

| Java | TEMAT E LËNDËS | Literatura referuese | Forma e mësimdhënies |
|---|---|---|---|
| | *fundit të sëmundjeve kronike, sëmundje obstruktive etj.*<br>*Qëllimi i këtij kujdesi paliativ është lehtësimi i dhembjeve dhe simptomave tjera të pakëndshme të sëmundjes kanceroze,të pacientit, i cili është në fazën e fundit të saj.*<br><br>**Praktikë mësimore -** Në pavionin e Reanimacionit, Kujdesit paliativ dhe Kimio-Terapisë. | | *Praktikë 2 orë* |
| **XIII.** | **Tema 37 – 38 -** Kujdesi paliativ ne semundjet onkologjike.<br>*Qëllimi i këtij kujdesi paliativ është lehtësimi i dhembjeve dhe simptomave tjera të pakëndshme të sëmundjes kanceroze,të pacientit, i cili është në fazën e fundit të saj.*<br>**Tema 39-** Kujdesi paliativ në pacientët geriartrikë<br>*Parimet e ofrimit të kujdesit paliativ. Kujdesi paliativ ofrohet në bazë të parimeve të mëposhtme: mbrojtja e dinjitetit dhe autonomisë së pacientit .*<br><br>**Praktikë mësimore -** Në pavionin e Reanimacionit, Kujdesit paliativ dhe Kimio-Terapisë. | *fq. 41 – 49*<br><br><br><br>*fq. 50 – 56*<br><br><br><br>*fq. 57 – 65* | Leksion 2 orë<br><br><br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br>*Praktikë 2 orë* |
| **XIV.** | **Tema 40 -** Kujdesi i pacientëve paliativ në fundin e jetës.<br>**Tema 41 - 42 -** Trajtimi i çështjeve etike dhe ligjore në kujdesin paliativ.<br>*Kujdesit Paliativ trajton jovetëm çështjen e vuajtjes dhe dhimbjes, por edhe ofrimin e kujdesit cilësor të jetës në të gjitha aspektet: fiziologjike, etike, shpirtërore të përkujdesjes ndaj pacientit*<br><br>**Praktikë mësimore -** Në pavionin e Reanimacionit, Kujdesit paliativ dhe Kimio-Terapisë. | *fq. 66 – 72*<br>*fq. 73 – 80* | Leksion 1 orë<br>Leksion 2 orë<br><br><br><br><br>*Praktikë2 orë* |
| **XV.** | **Tema 43 - 44 -** Komunikimi me pacinetët paliativ.<br>*Modele, situata të veçanta të komunikimit. Barrierat dhe komunikimi i skuadrës.*<br>**Tema 45 -** Orët e fundit.<br>*Faza e fundit e sëmundjes pranohet nga pacienti dhe nga familja e tij si periudha e lamtumirës. Krahas sigurimit,çdo mjedis për pacientin, gjatë kësaj periudhe duhet të sigurohen kushte për ruajtjen e rutinës së përditshme të jetës së familjes.*<br><br>**Praktikë mësimore -** Në pavionin e Reanimacionit, Kujdesit paliativ dhe Kimio-Terapisë. | *fq. 81 – 87*<br><br>*fq. 87 - 90* | Leksion 2 orë<br><br>Leksion 1 orë<br><br><br><br><br>*Praktikë2 orë* |

| FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **FREKUENTIMI:** | Kërkohet një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 75%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrëveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit).<br>Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studenti humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura. | | | | | |
| **Mënyra e vlerësimit** | *Forma e vlerësimit* | *Koha e vlerësimit* | *Temat mësimore që do vlerësohen* | *Pikët maksimale* | *Forma e testimit të njohurive* | *Përmbajtja e testimit* |
| | Provimi I | Java 7/8 | 1-15 tema | 30 pikë | Provim me shkrim | pyetje me shtjellim, pyetje quiz, situata për menaxhim |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Provimi përfundimtar | Fundi i semestrit | 16-45 leksionet | 60 pikë | Provim me shkrim | pyetje me shtjellim, pyetje quiz, situata për menaxhim |
| | Vlerësim i vazhduar* | Java 14/15 | Raste klinike | 10 pikë | Prezantim oral | Raportim rasti |
| | *Vlerësim i vazhduar* – Do të jetë në formën e një fletoreje (fletorja e studentit) që do të nisë në fillim të semestrit. Studentët do të përshkruajnë rastet e proçedurave infermierore që do të realizojnë dhe asistojnë gjatë praktikës në patologjitë kirurgjikale, traumat, kujdesi paliativ, duke i krahasuar me përshkrimet teorike të patologjive. | | | | | |
| | Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare do të jetë si më poshtë: | | | | | |
| | 40- 49 pikë | 50-59 pikë | 60-69 pikë | 70-79 pikë | 80-89 pikë | 90-100 pikë |
| | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |

| LITERATURA | |
|---|---|
| **a. Literatura bazë e detyruar** | 1. **Teksti i traumës"** P. Prifti, 2006 (Fakulteti i Infermierisë - UT)<br>2. **Cikël leksionesh për "Kujdesin Paliativ "**2014 E. Noçka, R. Luci, i aprovuar nga Departamenti i Infermierisë, FSHP- UV |
| **b. Literatura e rekomanduar** | o Traumatologjia e aparatit lokomotor.' E. Gjika, V. Gjata, I.Mazniku, Gj. Caushi, V. Ruci. 2006, (FakultetiiMjekësisë - UT)<br>o Fractures classifications in clinical practice. Sayed Behrooz Mostofi 2006<br>o Vlieger M de, Gorchs N, Larkin PJ, Porchet F. Palliative nurse education: toëards a common language. Palliative Medicine (2004) 18: 401-03<br>o The Neë 2010 The Oxford Textbook of Palliative Nursing, 3rd Edition, edited by Betty Ferrell and Nessa Coyle<br>o ELNEC (End of Life Nursing Education Consortium) Academic Guide, City of Hope the American Association of Colleges of Nursing 2008, (rivised 2012) |

| VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS | |
|---|---|
| **Dispozita:** | Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregon interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjate procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuar. |
| **Vonesat** | Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student. |
| **Sjellja profesionale e studentit** | Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vet-ndërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, |

| | |
|---|---|
| | duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijancë nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit. |
| **Integriteti akademik dhe e drejta e autorit** | Çdo test apo punë me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale.<br>Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale, dhe në pamundësi të referojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzierjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme. |